



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 mars 2012
Nr. ref.: RK 214/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI-132/11

Parashtrues

Sabile Sopjani

Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë
Ac. nr. 601/02, të 15 shtatorit 2004

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Sabile Sopjani, nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Nr. 601/02, i 15 shtatorit 2004, me të cilin është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 123/2001, i 18 shtatorit 2002, dhe u refuzua kërkesa e parashtruesit të kërkesës që të kthehet në marrëdhënie të përhershme pune në Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK) ku, para shpërthimit të luftës në Kosovë, parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar i përhershëm.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Nr. 601/02, të 15 shtatorit 2004, pa cekur konkretisht se cilat nene të Kushtetutës janë shkelur, por nga kërkesa mund të shihet se objekti i çështjes është kontesti juridik për marrëdhënie pune mes parashtruesit të kërkesës dhe KEK-ut.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 17 tetor 2011, parashtruesi i kërkesës i parashtrroi kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 27 janar 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Komunale në Prishtinë, si dhe Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, se kanë filluar procedurat për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve lidhur me lëndën Nr. KI-132-11.
7. Më 20 mars 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Snezhana Botusharova, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesi i kërkesës ka themeluar marrëdhënie të përhershme pune në KEK, në pozitën e referentit të sigurimit, parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie pune deri më 1 prill 1999 kur së bashku me familjen është dëbuar nga Prishtina dhe si refugjat u deportua në Holandë.
9. Parashtruesi i kërkesës, me familje, është kthyer në Kosovë më 17 janar 2001, ndërsa kërkesën për kthim në vendin e punës e ka parashtruar më 2 shkurt 2001.
10. Me vendimin numër 46 të 29 janarit 2001, Drejtori i KEK-ut refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kthim në vend të punës, si të pabazuar. Me arsyetimin se, sipas rregullave të përkohshme për marrëdhënie pune të KEK-ut, afati i fundit për kthim të punëtorëve të dëbuar nga puna ka qenë më 1 qershor 2001.
11. Vendimi i drejtorit, numër 46 i 29 janarit 2001, është vërtetuar me vendimin numër 835 të Këshillit ekzekutiv të KEK-ut, të 1 marsit 2001.

12. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë ndaj këtyre vendimeve të KEK-ut, duke kërkuar anulimin e këtyre vendimeve dhe kthimin e tij në vend të punës, ndërsa mungesën e vet u mundua ta arsyetojë me sëmundje dhe pamundësi për t'u paraqitur në vendin e punës.
13. Gjykata Komunale në Prishtinë, me aktgjykimin C. nr. 123/2001 të 18 shtatorit 2002, refuzoi kërkesat e parashtruesit të kërkesës si të pabaza dhe dëshmitë për sëmundje i vlerësoi si jo bindëse.
14. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 601/2002 të 15 shtatorit 2004, e konfirmoi plotësisht Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 123/2001, të 18 shtatorit 2002.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 601/02, të 15 shtatorit 2004, duke theksuar:

„Ju drejtohem përmes kësaj kërkesë, pasi që më është shkelur e drejta për punë, si e drejtë themelore e njeriut. Dhe theksoj se jam paraqitur tek e paditura (KEK), por më është thënë se jam vonuar që të kthehem në punë, duke anashkaluar rrethanat që ishin, luftën, e unë si refugjat isha në Holandë, dhe se për shkak të përkeqësimit të gjendjes sime shëndetësore dhe fëmijës tim të vetëm, nuk kam mundur të kthehem sipas dëshirës sime, por vetëm përmes organeve holandeze. Por, është e çuditshme se tek e paditura ka punëtorë që janë kthyer shumë kohë pas meje, dhe e paditura i ka kthyer në punë.“

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
17. Në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata Kushtetuese konstaton se parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Br 601/02, të 15 shtatorit 2008. Kjo do të thotë se kërkesa ka të bëjë me ngjarje para 15 qershorit 2008, respektivisht para datës së hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në bazë të kësaj, kërkesa është dorëzuar pas afatit, dhe kësaj nuk është në përputhje *“ratione temporis”* me dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit (shih *mutatis mutandis Jasiūnienė kundër Lituanisë, Kërkesa nr. 41510/98, aktgjykimi i GJEDNJ-së të 6 marsit dhe 6 qershorit 2003*).
18. Rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (3h) të Rregullores së punës i cili parashikon që „një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur: h) kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.“

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 36 (3h) të Rregullores së punës, më 20 mars 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. Ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

